

Kush është Kush?

Pasi ju të arrini në Mbretërinë e Bashkuar (tutje MB) ju do të takoheni me shumë persona të ndryshëm. Por kush Jane ata? Ky është një udhëzim që t'ju ndihmojë të kuptioni punët e ndryshme që ata bëjnë dhe se si mund t'ju ndihmojnë juve.



Kjo fletushkë është e caktuar për fëmijët të cilët arrinë në MB dhe po kërkojnë azil.

Kërkonit nga një person i rritur që të lexojë këtë me ju nëse ju nuk e kuptioni.



*Pse të mos e mban
këtë fletushkë me ju
vele dhe t'i kërkon
njerëzit që takoni
për të treguar se
kush janë ata?*

Njerëzit e prezantuar në këtë fletushkë janë të renditur sipas radhës që ju do t'i takoni. Ata të gjithë posedojnë role dhe përgjegjësi të ndryshme edhe pse ndonjëherë duket sikur ata posedojnë punë të njejtë dhe janë të lidhur me njëri-tjetrin.

Disa persona, të prezantuar këtu në fletushkë duhet që të ndajnë informata rreth jush me disa persona profesional të tjerë, pasiqë që kjo i kërkon nga përgjegjësitë e punës që ata bëjnë. Kjo ndodh vetëm që sëbashku të punojnë në mënyrën më të mirë për ju; të ju ndihmojnë dhe të përkujdesen për ju.



Disa persona, të prezantuar këtu në fletushkë duhet që të ndajnë informata rreth jush me disa persona profesional të tjerë, pasiqë që kjo i kërkon nga përgjegjësitë e punës që ata bëjnë. Kjo ndodh vetëm që sëbashku të punojnë në mënyrën më të mirë për ju; të ju ndihmojnë dhe të përkujdesen për ju.





Përkhyesi

► Kush janë ata?

Detyra a një përkthyesi (Angl.: Interpretér) është që të siguroj që **të gjitha fjalët** që ju i thoni janë të **përkthyera qartë** në gjuhën Angleze ashtu siç ju i keni nënkuptuar, dhe t'i përkthejë të gjitha fjalët që i'u drejtohen ju në gjuhën Shqipe, në mënyrë që ju **të kuptoni**.

► Çfarë bëjnë ata?

Në **shumicën e takimeve** me persona, ka shumë mundësi që të jetë i pranishëm një **përkthyes t'ju ndihmojë juve në komunikim** dhe po ashtu ju **keni të drejtë** të kerkoni për një përkthyes. Përkthyesi nuk ka ndonje trajnim që të ju ofroje këshilla ligjore, dhe **nuk duhet të ju tregojë juve se çfarë duhet të bëni ose çfarë duhet të thoni**.

Nësë ju **nuk e kuptoni** përkthyesin tuaj, nëse ju mendoni se përkthyesi nuk po përkthen gjithçka, ose nëse keni ndonjë shqetësim tjetër atehërë ju duhet t'i tregoni dikujt. Nëse ju nuk ndiheni rehatshëm me përkthyesin tuaj për aryse të ndryshme, ju keni **të drejtën të kërkoni** për një përkthyes tjetër.






Oficer / Punonjës Emigracioni

► Kush janë ata?

Roli i Punonjësit së Emigracionit (Angl.: Immigration Officer) është që të sigurojë që **ligjet e emigracionit** të MB janë duke u **ndjekur**. Punonjësi i Imigracionit posedon të njëjtat **fuqi si të një oficer policie**, megjithatë ata nuk i takojnë policisë: ata punojnë për një pjesë të **qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar** e quajtuar Zyra e Punëve te Brendshme (Angl.: Home Office). Ata kanë përgjegjësi të sigurojnë mirëqenien dhe sigurimin tuaj.

► Çfarë bëjnë ata?

Kur ju të arrini në Mbreterinë e Bashkuar një punonjës emigracioni do të ju vendos në një vend të **sigurtë** gjatë kohës që ju e rimerrni veten tuaj pas udhëtimit. Punonjësi i emigracionit do të ju kerkojë informacion të thjeshtë si kush jeni dhe nga vini, dhe do të ju referojë tek një punonjës social, i cili do të cakohet për kujdesin tuaj. Ata edhe mund të regjistrojnë kërkesën tuaj për azil. Këta punonjës emigracioni nuk duhet që të ju intervistojnë juve në atë mënyrë që ju të merrni një vendim rreth çështjes se a dëshironi të qëndroni në Mbreterinë e Bashkuar apo jo, megjithatë ju gjithmonë duhet të jeni i singertë me ta dhe ata do të shkruajnë se ju çfarë thoni.





Punonjësi Social

► Kush janë ata?

Punonjës sociali (Angl.: Social Worker) është një person përgjegjës në ndihmë të fëmijëve në zonën e tyre locale. Nëse jeni i vetëm dhe pa përkrahje të familjës, ateherë autoritetet lokale kanë përgjegjësi per t'u kujdesur për ju. Ata do të bëjnë të mundur që juve të ju ofrohet një banesë e sigurtë, ushqim, veshmbathje, shërbim shëndetsor, shkollim dhe mënyra të tjera mbështetje si rrjedhojë e nevojavë që mund të keni. Kjo lloj ndihmesë perkufizohet si "Fëmijë nën Kujdestari" (Angl.: "looked after" ose "in care").

► Çfarë bëjnë ata?

Punojësi social është i ngarkuar të marre vendime rreth jush dhe përkujdsit tënd. Punonjësi yt social duhet t'ju **vizitojë** të paktën çdo 6 javë. Ata duhet të ju **dëgjojnë** me kujdes dhe të **perfshijnë dëshirat** dhe **ndjenjat** tuja emocionale në një plan te caktuar për shëndetin tuaj të përgjithshëm. Ata duhet t'i **shpjegojnë vendimet** e ndërmarra dhe të bëjne të mundur që fjala juaj të dëgjohet dhe të mos bjerë në vesh të shurdhër. Ata duhet gjithmonë të caktojnë një përkthyes nëse ju nuk kuptioni gjuhën Angleze. Nganjeherë ju mund të keni më shumë se një punonjës sociali sepse ata mund të ndërrohen. Mbajeni **emrin** dhe **numrin e kontaktit** të punonjësit social gjithmonë me vete.





Kujdestari birësues

► Kush janë ata?

Kujdestari birësues (Angl.: Foster Carer) është një person që **hap dyert e shtepisë** së tij që të ofrojë **përkujdes tek femijët** që nuk kanë familje e cila mund kujdeset për ta.



► Çfarë bëjnë ata?

Kujdestarët ofrojnë një strehim të sigurtë. Ata do të **kujdesen për ju** çdo ditë, do të ju dërgojnë në shkollë dhe do të sigurojnë përbushjen e nevojave bazike si **veshmbathje dhe ushqim**.

Kujdestari gjithashtu do të ketë kontakte me disa persona të tjerë të përfshire në jetën tuaj si p.sh. me punonjësin social (Angl.: Social Worker), doktorin, **avokatin, dhe mësuesit tuaj**.

Mënyra e tyre e jetesës në familje mund të mos jetë ashtu si jeni mësuar, por nëse e gjeni këtë të veshtirë është e rëndësishme të ndani ndjesitë tuaja sepse vetëm kështu ata mund të ju ndihmojnë.





Infermiere e përcaktuar për femijët dhe praktikant i pergjithshëm (Mjeku i lagjes apo komunës)

► Kush janë ata?


Infermierë e përcaktuar (Angl.: Designated Nurse) është infermerja që **kupton problemet dhe shqetësimet** e femijëve të përkujdesur nga shërbimet sociale. Ata do të bashkëpunojnë me punonjësit sociale që të bëjnë të mundur plotësimin e nevojave tuaja shëndetsore.

Praktikant i Përgjithshem (Angl.: General Practitioner, GP) është **mjeku i komunës** që siguron **trajtime keshilla** mjekësore për popullatën e një zone apo komune të caktuar.

► Çfarë bëjnë ata?

Infermieri/a e përcaktuar ka për detyrë të ju ekzaminojë dhe të sigurohet nëse juve keni ndonjë problem të mundshëm mjekësor. Ky quhet "ekzaminimi i pare" (Angl.: "first assessment"). Ky takim duhet të caktohet sa më shpejtë të jetë e mundur pasi që ju të keni **arritur** në MB. Ju mund të lini takim me **doktorin** pa pagesë nëse keni ndonjë problem shendetësor ose kur ndjeheni **të trishtuar** apo keni **probleme me gjumin**. Ju **nuk keni** nevojë të paguani për trajtimin shendetësor në Mbretërine e Bashkuar përfshire takimet tek dentisti dhe okulisti.

Mos kini frikë të tregoheni të **sinqertë** me infermieren apo doktorin rrëth **problemeve** që po kaloni. Infermierja e juaj e përcaktuar mund t'ju bëjë të mundur caktimin e një përkthyesi që mund të ju shoqërojë në takimet tuaja.





*Më bën të njëjtat
pyetje, dhe u ndjeva
sikur nuk më besuan.
Duhet të flasësh rreth
çdo gjëje me lehtësi.
Por disa herë mu desh
ta detyroja veten.*

Ju mund të shkoni përgjatë intervistave të ndryshme me individ të ndryshëm, që mund të jetë frustruese. Tregohuni të duruar.

Nëse keni ndonjë vështirësi në të përgjigjur, nëse ndjeheni të frikësuar, turpëruar, jo mirë, ose nuk mban mend, ju mund të shpjegoni këtë. Është normale të thoni "nuk mund të flas per këtë tan".

Nëse nuk thoni gjë, atëherë personi interviewues nuk mund të jetë në gjendje të dije këtë, dhe është e rendësishme që ata të kuptojne.

- **Mos u shqetësoni se dikushi mund të zemërohet me ju ose nëse mendojne që ju po bëheni i vrazhdë**
- **Nëse ju keni vështirësi në të kuptuarit e rregullores së shkollës ose në shtëpinë strehuese - Pyesni**

Qëndro i fortë, për çfarëdo goftë arsy. Nëse shikoj mbrapa, çdogjë stres apo shqetësim që mund të mërzise, puno më shumë sepse unë për pak u dorëzova. Edhe pse gjerat duken që shkojnë keq, nuk është fundi.



Mos keni frikë! Këta njerëz janë këtu që të ju ndihmojnë juve. Mundohuni që të jeni sa më të hapur që është e mundur me ata, sepse kjo e lehtëson punën e tyre që të ju ofrojnë ndihmë më lehtë.

- **Është e rendësishme të ndani informacione dhe të jeni të sinqertë**
- **Bëni sa më shumë pyetje që të jetë e mundur dhe bëjeni me dije nëse nuk jeni dakort me ndonjë gjë**





Avokati/ perfaqësuesi ligjor

► Kush janë ata?

Avokat është një person që **i di dhe i kupton ligjet**. Një avokat i emigracionit është person i specializuar në ligjet që Zyra e Brendshme (Angl.: Home Office) do të perdor për të marr një vendim rrëth aplikimit tuaj për azil, por gjithashtu ka avokatë të cilët janë të specializuar, në **ligjin mbi krime, ligjin për familje**, dhe ligjin për shërbime sociale.


► Çfarë bëjnë ata?

Avokati punon për ju. Avokati do ti ju ndihmojë të kuptoni se çfarë do të ndodhë me ju ndërsa ju shkoni përgjatë procesit të azilit, dhe si **ligjet** dhe **procedurat** e ndryshme mund të aplikohen në çeshtjën tuaj. Që të janë në gjendje të bëjne këtë ata duhet të janë në dijeni se çfarë ju ka ndodhur. Ata duhet të dëgjojnë se çfare keni për të thënë.

Ata do ta kenë të nevojshme të ju **takojnë disa herë** ndërsa janë duke pregetitur çeshtjen tuaj të azilit, kështu që ata mund të arrijnë të kuþtojnë në detaje të plota se çfarë ju ka ndodhur. Nëse ju nuk e kuþtoni avokatin tuaj, ose keni frike apo turp të flisni me të, ju duhet t'i tregoni një personi tjetër. Ju mund të jeni në gjendje të punoni me një avokat tjetër.

Avokati duhet të jetë në gjendje të identifikoje detaje të **ekspériencës ténë** që janë të rendësishme për çeshtjen tuaj të azilit. Ata duhet të ju shoqerojnë në të gjitha intervistat formale me oficerët e emigracionit ose policinë dhe të sigurojnë që ju të **dorëzoni informacionin e kërkuar ne kohë**.

Avokati **nuk duhet të kërkojë shpërblim financiar** per të punuar në çeshtjën tuaj të azilit. Ata mund të bëjnë një aplikim në emrin tuaj tek një agjensi qeveritare kundrejt një pagese e quajtur "ndihmë juridike", për të pregetitur çeshtjen tuaj, por kjo nuk do të thotë që ata punojnë për ketë qeveri.





Person i duhur ose Përgjegjës

► Kush janë ata?

'Person përgjegjës' (Ang.: Responsible adult) ose "person i duhur" (Ang.: Appropriate adult) është një person përgjegjës për të mbrojtur të drejtat dhe **mirëqeniën** e femijës gjatë intervistimit.

► Çfarë bëjnë ata?

Një i rritur i përshtatshëm do të ju shoqërojë juve në intervistë si p.sh. **intervista e azilit**, intervista e përcaktimit të moshës që është një proces formal për të **përcaktuar moshën tuaj**, ose interviste policie. Ata do të ju sigurojnë mbështetje të pavarur, duke bërë të mundur tërheqjen e vemandjës së intervistuesit për sa i përket nevojave tuaja, duke u siguruar që ju të kuptioni se çfarë po ndodh dhe jeni në gjendje të komunikoni. Një person përgjegjës mund të jetë **kujdestari juaj bireshuës, punonjësi social, një punonjës i organizates mbeshtetese së refugjateve, ose një kujdestar i juaji**, por ai duhet të jetë një person që ju e njihni dhe i besoni.





Oficeri i Zyrës së Brendshme caktuar vetëm për çeshtjën tuaj


► Kush janë ata?

Oficeri i zyrës së brendshme për çeshtjen tuaj (Angl.: Home Office Case Worker) do t'ju **bëj pyetje rreth kërkesës suaj për azil** në formen e një interviste, do të **egzaminojë** të gjithë **evidencat** që ju ose avokati juaj do të paraqesë në lidhje me çeshtjën tuaj dhe të krahasojë këtë me **informacionin** dhe **udhezuesin** qeveritar. Ata do të perdonin të gjithë këtë informacion për të marrë një vendim rreth **lejëqendrimit** që mund të ju jepet per të **qendruar** në Mbretërinë e Bashkuar.

► Çfarë bëjnë ata?

Është e rendësishme që t'i jepni oficerit të çeshtjes tuaj **sa me shumë informacione** të jetë e mundur rreth çeshtjes suaj të azilit. Officer i çështes tuaj duhet të ju bëje të ndiheni mirë dhe t'ju ndihmojë juve të shpjegoni çfarë ka ndodhur duke bërë pyetje dhe duke dëgjuar përgjigjet tuaja. **Mos u frikësoni** t'i tregoni oficerit për çdo gjë që ju ka ndodhur- nëse ju nuk i tregoni ata nuk kanë ndonjë mënyre magjike për ta ditur. Është gjithashtu shumë e rendësishme të tregoni gjithmonë të vërtetën dhe të tregoni kur nuk e dini pyetjën ose nuk jeni të sigurte rreth përgjigjes. **Vendimi i oficerit nuk është perfundimtarë** sepse ju mund të keni të drejtën për apelim (Ang.: appeal).

Nëse juve jeni referuar tek "Mekanizmi i Referimit Kombëtar" (Ang.: National Referral Mechanism, NMR) ateherë një oficer tjetër emigracioni do të vendos nëse juve jeni i trafikuar apo jo. Ky vendim duhet te jetë i vecuar, por informacioni për se cilin vendim mund të jepet ndërmjet oficerëve të ndryshëm të çeshtjës.





Oficeri i Policisë

► Kush janë ata?

Oficeri i policisë (Ang.: police officer) është përgjegjës per të mbajtur popullatën të sigurte, duke zbatuar ligjet e Mbreterisë së Bashkuar dhe duke investiguar krimin. Oficerët e policise gjithashtu duhet të zbatojne ligjin.

► Çfarë bëjnë ata?

Në rast rreziku ose për të raportuar një krim ju duhet të flisni me policinë sa më shpejtë që është e mundur. Thërrisni 999.

Nëse ju keni frikë të flisni me policinë ose nuk dëshironi që t'i jepni të dhënat e juaja personale atëherë flisni me një person tjetër të cilit ju i besoni. Krimet gjithsesi mund të raportohen edhe pa dhënë të dhënat tuaja personale.

Ligji mbi krimin ne Mbreterinë e Bashkuar mund edhe të jetë ndryshe nga ligji mbi krimin në vendin tuaj. Për shembull, ju mund të gjobiteni nëse hidhni një cigare në rrugë. Pyesni punonjësin social ose një person tjetër të ju ndihmoje juve t'i kuptioni ligjet me shumë.

Nëse ju jeni akuzuar për një krim, atëherë ju keni të drejtë të keni një avokat me ju, ndërsa jeni intervistuar nga një oficer policie.

Nëse një person tjetër ju ka detyruar juve të bëni një krim atëherë ju jeni viktim, dhe ne këte rast juve ju duhet ndihmë dhe mbrojtje.



Të gjithë fëmijët posedojnë të drejta të barabarta

- Të kesh të drejtat tuaja
- E drejta për **strehim, ushqim, dhe veshmbathje**
- E drejta për tu **mbrojtur nga dhuna dhe abuzimi**
- E drejta të shikoni doktorin/dentistin dhe **të keni trajtimin mjekësor falas**
- E drejta për shkollim me kohë **të plotë dhe falas**
- E drejta për **të mos u izoluar**
- E drejta për **të gjetur familjen tendë**
- E drejta për **të mos u diskriminuar**
- E drejta për t'u **zhvilluar plotësisht** si individ deri sa të arrini maturinë

Fakt: Në sytë e ligjit të Mbreterisë së Bashkuar, një person është fëmijë deri ne moshën 18 vjeç. Autoritetet lokale kane për detyrë ligjore të kujdesën per një fëmijë pa familje, derisa ata të arrijne moshën 18 vjeç, dhe në disa rrethana ata të mbështesin përtej kësaj moshe. Prandaj femijët e pashoqëruar që kërkojnë azil në Mbreterinë e Bashkuar merren në kujdestari.

Ju keni **të drejtën për t'u mbrojtur** nga të gjitha llojet e dhunës fizike, dhunës mendore, shfrytëzimit ose neglizhimit. Nëse:

- dikushi ju lëndon
- një i rritur nuk kujdeset si duhet
- nëse dikushi ju detyron të punoni për ta ose ju detyron të beni gjëra që nuk keni dëshirë
- Ju nuk jeni i lirë të largoheni nga vendi ku jetoni*
- Dikushi ju thotë se mund të bëje keq ty apo familjës tënde
- Nuk jeni të lirë se ju i detyroheni diçka dikujt ,ose jeni të frikësuar për arsyet tjeter

... ka njerëz që mund të ju ndihmojnë, por ju duhet të besoni dhe ti tregoni dikujt.Ti tregoni punojësit social, personit kujdestar, ose çdo personi në këtë fletushkë që ju ndjeheni rehat ose telefononi çdo njërin nga numrat.

* Ndonjëherë kur autoritetet lokale besojnë që ka një person të rritur ne Mbrëterinë e Bashkuar dhe kontakti i këtij personi me ty mund të jetë i irrezikshem, atëherë ata mund të kufizojnë se ku mund të shkonit dhe kë mund të takoni për një periudhë të caktuar kohe që të ju mbajnë larg rrezikut. Ata duhet tu'a shpjegojnë juve këtë. Nëse juve jeni të pakënaqur ose të çorrientuar ju mund të flisni me përfaqësuesin tuaj ligjor/ avokatin, ose një person tjetër për këtë

Ju duhet të bsoni edhe pse jeni në rrezik. Mbase ju ndjeheni që asnjëri nuk kujdeset për ju, ose ju nuk njihni njeri, por është dikush që kujdest për ju.





Mësues i caktuar

► Kush janë ata?

Mësues i caktuar (Ang.: designated teacher) është mësues në shkollë apo kolegj që ka **përgjegjësi** pér femjët që janë nën kujdesin e autoriteteve lokale. Ata mund të mos ju mësojnë ndonjë lëndë edukimi. Ata mund të jenë paksa në dijeni të **situatës** suaj por mbase nuk mund të jenë në dijeni rreth gjëra personale apo rreth familjes suaj dhe pse ju jeni një fëmijë nën kujdestari.

► Çfarë bëjnë ata?

Mësuesi i caktuar do të **ndihmojë** shkollën apo kolegin tuaj të ju **mbështes** si duhet në dhënen e ndihmës kundrejt teje, duke u siguruar që ju jeni të përfshire si duhet në edukim dhe si jeni duke mësuar. Ata do të sigurohen që shkolla apo kolegji juaj kupton problemet që mund të **ndikojnë** në **edukimin tuaj** dhe do të mbajnë të shënuar securinë tuaj. Gjithashtu ata janë përgjegjës pér "Planin Personal te Shkollimit" (**Ang.: Personal Education Plan, PEP**).

Një mësues i përcaktuar do të bisedoj rregullisht me punonjësin social rreth securisë tuaj në shkollë. Mësuesi i përcaktuar nuk duhet t'i tregoje nxënësve të tjera që ju jeni një fëmijë nën kujdestari ose t'ju trajtojë ndryshe përpëra tyre.



Be not afraid of greatness:
some are born great,
some achieve greatness,
and some have greatness
thrust upon them.



Terapist

► Kush janë ata?

Terapisti ose psikoterapisti (Ang.: therapist) është persono që ndihmon njerëzit si të menaxhojnë **stresin** ose **probleme** të tjera, në kohën që ata perjetojnë periudha të vështira. Nëpërmjet terapisë njerëzit mësojnë rreth vërvetes dhe zbulojne si të tejkalojne **vështirësite** ose të bëjne ndryshime në vërvete ose në situatat e tyre. Shpesh herë është ndjesi e mirë të kesh një person me kë të flasësh.

► Çfarë bëjnë ata?

Gjërat që të kanë **ndodhur në vendin tuaj**, ndersa udhëtonit në Mbretërinë e Bashkuar, edhe kur keni mbërritur këtu, mund të ju shkaktojnë **ndjesi të vështira**. Ju mund të ndjeheni të mërzitur, të zemëruar dhe me vështicësi në të **fjetur**. Ju mund të ndieheni akoma të **frikësuar**. Duke punuar me një therapist juve mund të kuptioni ndjesitë tuaja dhe të mësoni si ti ndalon që të ndikojnë negativisht tek ju. Kjo mund të ju ndihmojë të përqendroheni në jetën tuaj të përditshme dhe të ardhmen tuaj. Terapisti mund të jetë në gjendje të jap **evidencë** e cila mund të ju ndihmojë në **çështjen e azilit** nëse ju jeni dakort me këtë. Nëse ju ndjeheni qe doni të flisni me një therapist pyesni punëtorin tuaj social , kujdestarin birësues ose perfaqësuesin ligjor/ avokatin.





Oficer për rishikim të pavarur

► Kush janë ata?

Oficeri pér rishikim tē pavarur (Ang.: Indepenedent

Reviewing Officer, IRO) bën tē sigurtë që **Autoritetet Lokale** tē përkujdesen siç duhet dhe bëjne punën që u takon ndërsa juve jeni nën kujdesin e tyre. Oficeri i pavarur është perjegjës per tē siguruar që strehimi është i pershatshëm pér ju dhe ju jeni tē **kenaqur**. Ky officer është i **pavarur** dhe i **veçuar** nga shërbimet sociale.

► Çfarë bëjnë ata?

Oficeri i pavarur, duhet tē kontrolloj që plani i përkudesit tuaj tē jetë i përshtatshëm pér tē **ardhmen** tuaj, që çdokush tē dëgjoj se çfarë keni pér tē thëne dhe ta konsiderojnë me kujdes, dhe çdokush t'i përmbahet pjesëve të planit. Ju duhet tē **takoheni** me oficerin e pavarur tē rishikimit tē pakten **çdo 6 muaj**.

Është shumë e rendësishme t'i tregoni Oficerit tē pavarur nëse ka probleme me perkujdesin që ofrohet, nëse ndiheni që punonjësi social nuk po ju dëgjon me kujdes, ose ka probleme që nuk janë zgjidhur akoma.



Numra telefoni të dobishëm dhe faqe internet

Në raste emergjencë: Telefononi policinë, ambulancën, apo zjarrfikësin në numrin 999

Nëse jeni të frikësuar, të vettmar, të shqetësuar, të trishtuar, hutuar ose keni nevojë për këshilla; Telefononi linjën e femijëve pa pagesë në 08001111 në çdo kohë.

Ose vizitoni www.childline.org.uk

Për mbështetje pa pagesë, këshillim dhe informacion veçanërisht për fëmijët

nën kujdestari ose që jetojnë larg nga familjet ; Telefono në linjën këeshilluese të komisionerit të femijëve: "Ndihma në dore" në 08005280731 (9 në Mengjes-5 Mbasdite posdrte, nga e Hëne deri të Premten) ose vizitoni www.childrenscommissioner.gov.uk/learn-more/help-at-handHelp

Nëse jeni të detyruar të punoni ose të bëni gjëra që nuk doni, nëse nuk jeni të lirë tē largoheni nga vendbanimi aktual, nëse dikushi ju kercënon ju ose familjen tuaj, ose jeni të lënduar, ose dikush ju kontrollon në një mënyre apo tjetrën: Telefononi në linjën e ndihmës së Skllavërisë Moderne për këshilla në çdo kohë në 08000 121 700

Nëse keni nevojë për këshilla dhe mbështetje rreth tē qenurit fëmijë azil kërkues

i pashoqëruar; Telefononi në seksionin e fëmijevë n ë Keshillin e Refugjatëve në 020 7346 1134
ose dërgoni një letër elektronike në: children@refugeecouncil.org.uk

kërkoni për ndihmë afér jush : www.miclu.org/servicesmap

If you are an adult and you want to help a child who you think might have been trafficked or is in danger of exploitation, or if you would like to understand more about the asylum process, you can find useful information below:

NSPCC's Child Trafficking Advice Centre:

www.nspcc.org.uk

NSPCC have a helpline 0808 800 5000 and email too:

www.nspcc.org.uk/preventing-abuse/child-abuse-and-neglect/child-trafficking

Every Child Protected Against Trafficking (ECPAT):

www.ecpat.org.uk

Coram Children's Legal Centre - Migrant Children's Project:

www.childrenslegalcentre.com/about-us/what-we-do/migrant-childrens-project